

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 111/2017 “PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 111/2017 ‘Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti’”, synon forcimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, rritjen e aksesit real, efektiv dhe të barabartë të individëve në drejtësi, veçanërisht të personave në kushte të pafavorshme ekonomike, sociale ose juridike.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ka krijuar bazën ligjore për organizimin, administrimin dhe financimin e ndihmës juridike parësore, ndihmës juridike dytësore, si dhe përjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Nëpërmjet këtij ligji është synuar garantimi i mbrojtjes së të drejtave themelore të individit dhe i interesave të tij të ligjshëm, duke përcaktuar format, kushtet, procedurat dhe institucionet përgjegjëse për funksionimin e sistemit të ndihmës juridike.

Pavarësisht arritjeve të deritanishme në ngritjen dhe konsolidimin e sistemit të ndihmës juridike, praktika e zbatimit të ligjit, raportimet institucionale dhe analizat e kryera kanë evidentuar nevojën për rishikimin e disa dispozitave, me qëllim rritjen e efektivitetit të shërbimit dhe adresimin e pengesave që kufizojnë aksesin real në drejtësi. Këto pengesa lidhen, ndër të tjera, me mungesën e informacionit të qytetarëve për shërbimet e ndihmës juridike, kufizimet në kategoritë përfituese, barrën administrative në procedurën e përfitimit të ndihmës juridike parësore, nevojën për nevojën për një rol më aktiv të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (në vijim DNJF), mungesën e koordinimit me shërbimet në nivel vendor, nevojën për specializim më të lartë të avokatëve, si dhe mbulimin e pamjaftueshëm të disa shpenzimeve të domosdoshme në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Në këtë kuadër, projektligji synon forcimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, duke adresuar problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 111/2017 dhe duke përmirësuar aksesin efektiv në drejtësi për kategoritë përfituese, nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve kryesore:

- forcimin e rolit të ndihmës juridike në informimin, edukimin ligjor dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi të drejtat, detyrimet dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë;
- përfshirjen e njësive të vetëqeverisjes vendore si aktorë mbështetës në funksionimin e sistemit të ndihmës juridike, veçanërisht për informimin, referimin dhe bashkërendimin me shërbimet sociale;
- zgjerimin dhe qartësimin e kategorive të veçanta përfituese të ndihmës juridike, duke përfshirë viktimat e formave të ndryshme të dhunës, viktimat e terrorizmit, viktimat e krimit, personat me aftësi të kufizuara, përfituesit e skemave të mbrojtjes sociale, komunitetin rom dhe egjiptian, si dhe sinjalizuesit që raportojnë shkelje të së drejtës së BE-së sipas kuadrit ligjor evropian;
- thjeshtimin e procedurës për përfitimin e ndihmës juridike parësore, duke reduktuar barrën administrative për kërkuesit;
- përmirësimin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, përmes parashikimit të çështjeve të ndërlidhura, vijueshmërisë së përfaqësimit dhe shmangies së fragmentarizimit të mbrojtjes juridike;
- krijimin e procedurave të përsheptuara për dhënien e ndihmës juridike në rastet emergjente, veçanërisht për viktimat e dhunës dhe kategoritë e tjera vulnerabël;
- rritjen e cilësisë së përfaqësimit përmes trajnimit dhe specializimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore;
- zgjerimin e mbulimit të shpenzimeve të domosdoshme për aksesin në drejtësi, veçanërisht në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- harmonizimin e kuadrit ligjor vendas me standardet përkatëse të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së viktimave, garantimit të ndihmës juridike në procedurat penale, luftës kundër terrorizmit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Nisma ligjore është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë

vitit 2026, miratuar me vendimin nr. 812, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave.

Projektligji është në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, miratuar me vendimin nr. 787, datë 18.12.2024, të Këshillit të Ministrave, veçanërisht me objektivat që lidhen me rritjen e aksesit në drejtësi, forcimin e shërbimeve të ndihmës juridike dhe afrimin e sistemit të drejtësisë me qytetarët.

Projektligji është në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, të miratuar me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave, si dhe me planin e saj të veprimit dhe pasaportën e treguesve.

Gjithashtu, projektakti është në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, miratuar me vendimin nr. 16, datë 11.1.2024, të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti””, përfshihet në aktet për të cilat synohet përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian, për vitin 2026, në grup-kapitullin 1 “Themelorët”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ka krijuar kuadrin bazë për organizimin, administrimin dhe ofrimin e ndihmës juridike parësore, ndihmës juridike dytësore, si dhe përjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Ky ligj përcakton se ndihma juridike jepet me qëllim garantimin e aksesit të barabartë të individëve në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të ligjshëm të tyre. Megjithatë, gjatë zbatimit në praktikë të dispozitave të ligjit, është evidentuar nevoja për ndërhyrje të mëtejshme, me qëllim që ndihma juridike e garantuar nga shteti të mos kufizohet vetëm në njohjen formale të së drejtës, por të sigurojë akses real, efektiv dhe të përdorshëm nga përfituesit.

1. Një nga problematikat e konstatuara lidhet me mungesën e informacionit dhe nivelin e kufizuar të edukimit ligjor të publikut, veçanërisht të kategorive vulnerabël. Ligji parashikon krijimin e një sistemi për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, miradministrimin e institucioneve përgjegjëse dhe ofrimin cilësor të shërbimeve, por nuk përcakton shprehimisht funksionin e ndihmës

juridike si instrument për informimin, edukimin ligjor dhe ndërgjegjësimin e publikut.

Projektligji ndërhyr në nenin 2 të ligjit, duke shtuar si qëllim të ligjit kontributin e ndihmës juridike në informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi të drejtat, detyrimet dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë. Ky ndryshim plotësohet edhe nga ndërhyrja në nenin 8, ku DNJF-së i shtohet detyra për të informuar dhe ndërgjegjësuar publikun dhe subjektet përfituese, si dhe për të kontribuar në edukimin ligjor përmes materialeve informuese, fushatave ndërgjegjëse dhe aktiviteteve në komunitet.

2. Me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit, projektligji përfshin njësitë e vetëqeverisjes vendore si aktorë mbështetës dhe shton nenin 9/1, ku përcaktohen detyrat e tyre për informimin e publikut, vendosjen në dispozicion të dokumentacionit brenda fushës së tyre të përgjegjësisë dhe bashkërendimin me shërbimet sociale dhe institucionet përgjegjëse për ndihmën juridike.

Kjo ndërhyrje synon të ndihmojë qytetarët në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm, pa krijuar barrë të panevojshme administrative për njësitë vendore.

3. Një tjetër ndërhyrje lidhet me zgjerimin e kategorive të veçanta të përfituesve të ndihmës juridike. Në nenin 11 të ligjit nr. 111/2017 parashikohet lista e kategorive përfituese të ndihmës juridike pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë, si viktimat e krimit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzuara seksualisht dhe të trafikimit, të miturit, personat me aftësi të kufizuara, personat që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, përfituesit e skemave të mbrojtjes sociale dhe personat e diskriminuar. Zhvillimet e reja ligjore dhe praktika e deritanishme e zbatimit të ligjit nr. 111/2017, kanë treguar se kjo listë ka nevojë të zgjerohet dhe të qartësohet.

Projektligji ndryshon nenin 11, duke përfshirë shprehimisht viktimat e krimit, viktimat e dhunës në familje dhe të formave të tjera të dhunës të parashikuara në legjislacionin civil dhe penal për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, viktimat e terrorizmit, personat që kërkojnë njohjen e statusit të aftësisë së kufizuar, përfituesit e ndihmës ekonomike, pensionit social dhe skemave të tjera të mbrojtjes sociale, personat e komunitetit rom dhe egjiptian për çështje të dokumentacionit dhe regjistrimit civil, si dhe personat që raportojnë ose bëjnë publik informacion mbi shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian.

4. Sa i përket ofrimit të ndihmës juridike parësore, projektligji synon thjeshtimin e procedurës dhe reduktimin e barrës administrative për qytetarët. Ligji në fuqi parashikon se kërkesa për ndihmë juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim pranë një qendre shërbimi ose organizate jofitimprurëse të autorizuar dhe se kërkuesi duhet të paraqesë vetëdeklarim të shoqëruar me dokumentacion justifikues. Në praktikë, ky parashikim mund ta afrojë procedurën e ndihmës juridike parësore me atë të ndihmës juridike dytësore, duke e rënduar në mënyrë të panevojshme aksesin në këshillim fillestar.

Me qëllim adresimin e kësaj çështjeje, projektligji ndërhyt në nenin 17, duke parashikuar se kërkesa i drejtohet ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe se personi nënshkruan vetëdeklarim të shoqëruar me dokument identifikimi, ndërsa dokumentacioni justifikues kërkohet vetëm kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e vetëdeklarimit.

Gjithashtu, projektligji thjeshton dokumentimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore, duke reduktuar të dhënat dhe dokumentacionin që kërkohet nga përfituesi. Procesverbali kufizohet vetëm në të dhënat e nevojshme për identifikimin e kërkuesit, përshkrimin e problematikës dhe shërbimin e ofruar, me qëllim lehtësimin e procedurës dhe shmangien e barrës së panevojshme administrative.

5. Lidhur me ndihmën juridike dytësore, projektligji ndërhyt në nenin 19 të ligjit, duke parashikuar që kërkesa për ndihmë juridike dytësore të mund të paraqitet jo vetëm për një proces të caktuar, por edhe për çështje të ndërlidhura ndërmjet të njëjtave palë. Ky ndryshim është i rëndësishëm, sidomos për rastet kur një situatë faktike prodhon disa procedura të ndryshme civile, penale ose administrative. Në këto raste, trajtimi i ndihmës juridike si e kufizuar vetëm në një proces të izoluar mund të sjellë fragmentarizim të mbrojtjes juridike dhe ulje të efektivitetit të përfaqësimit.

Për rrjedhojë, projektligji parashikon që për disa kategori përfituese, përfshirë azilkërkuesit, viktimat e dhunës, viktimat e terrorizmit, viktimat e trafikimit, të miturit dhe persona të tjerë vulnerabël, ndihma juridike dytësore të sigurohet, sa të jetë e mundur, nga i njëjti avokat gjatë fazave paraprake dhe procesit gjyqësor, përfshirë çështjet civile, penale dhe administrative të ndërlidhura.

6. Projektligji parashikon një procedurë të posaçme dhe të përsheptuar për dhënien e ndihmës juridike dytësore në rastet urgjente. Kjo ndërhyrje është e nevojshme pasi procedura e zakonshme e shqyrtimit të kërkesës, nga gjykata ose

organi procedues, nuk i përgjigjet gjithmonë nevojës për mbrojtje të menjëhershme të personave që ndodhen në situata emergjente. Për kategori të caktuara, si viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, viktimat e dhunës seksuale, viktimat e trafikimit, viktimat e terrorizmit, të miturit dhe personat me aftësi të kufizuara, nevoja për ndihmë juridike mund të jetë e menjëhershme dhe e lidhur me mbrojtjen urgjente të të drejtave dhe interesave të tyre.

Për këtë arsye, projektligji shton nenin 22/1, duke parashikuar procedurën e përshpejtuar për dhënien e ndihmës juridike dytësore në rastet emergjente, ku formulari mund të plotësohet edhe nga institucioni ose struktura pranë së cilës identifikohet apo referohet rasti, ndërsa gjyqtari cakton menjëherë avokatin dhe urdhëron njoftimin pa vonesë të avokatit dhe përfituesit.

Në funksion të mbrojtjes së viktimave edhe në procesin penal, projektligji shton nenin 21/1, i cili rregullon procedurën e dhënies së ndihmës juridike dytësore për viktimat në procesin penal. Kjo dispozitë parashikon shqyrtimin e menjëhershëm të kërkesës nga organi procedues ose gjykata për subjektet përfituese, si viktimat e dhunës, viktimat e terrorizmit dhe viktimat e abuzuara seksualisht apo të trafikimit, caktimin e menjëhershëm të avokatit dhe vijueshmërinë, sa të jetë e mundur, të përfaqësimit nga i njëjti avokat në të gjitha fazat e hetimeve paraprake dhe procesit gjyqësor, përfshirë çështjet e ndërlidhura civile, penale dhe administrative.

7. Projektligji ndërhyt në nenin 24, që rregullon dhënien e ndihmës juridike dytësore nga avokatët. Dispozitat në fuqi parashikojnë caktimin e avokatit nga dhoma vendore e avokatisë sipas parimit të rotacionit dhe zëvendësimin e tij vetëm në rast konflikti interesi.

Projektligji e zgjeron këtë qasje, duke parashikuar të drejtën e përfituesit të ndihmës juridike dytësore për të zgjedhur avokatin nga lista e avokatëve që ofrojnë këtë shërbim. Caktimi sipas parimit të rotacionit zbatohet kur përfituesi nuk e ushtron këtë të drejtë, kur avokati i zgjedhur nuk pranon ose kur ndodhet në pamundësi objektive për të marrë përsipër përfaqësimin. Gjithashtu, zëvendësimi i avokatit lejohet jo vetëm në rast konflikti interesi, por edhe në rast pamundësie objektive ose për shkaqe të tjera të arsyeshme që cenojnë mbrojtjen efektive të përfituesit.

Në të njëjtin nen, projektligji forcon elementin e specializimit profesional të avokatëve. Ligji në fuqi kërkon që avokatët të jenë të specializuar në fusha të së drejtës kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve

dhe viktimave. Projektligji e forcon këtë element, duke e lidhur specializimin dhe trajnimin e avokatëve me natyrën e çështjes dhe me kategoritë e posaçme përfituese, me qëllim rritjen e cilësisë së përfaqësimit.

8. Një tjetër problematikë që trajton projektligji i referohet shpenzimeve të nevojshme për realizimin efektiv të së drejtës, veçanërisht në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Ligji nr. 111/2017, parashikon përjashtimin nga tarifat gjyqësore, shpenzimet gjyqësore dhe detyrimin për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit. Nisur nga praktika, përfituesit mund të përballen edhe me shpenzime të tjera të domosdoshme, si tarifa kadastrale, noteriale, shpenzime përmbarimore ose shpenzime të tjera të lidhura me ekzekutimin.

Për këtë arsye, projektligji shton përkufizime të reja për shpenzimet kadastrale dhe noteriale, si dhe për tarifat e tjera të domosdoshme gjatë ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu, ndryshimet në nenet 25 dhe 29 synojnë të zgjerojnë përjashtimet nga parapagimi ose pagesa e këtyre shpenzimeve, kur ato janë të nevojshme për realizimin efektiv të së drejtës.

9. Projektligji forcon gjithashtu rolin e DNJF-së në mbrojtjen e interesit publik dhe administrimin e fondeve të ndihmës juridike.

Ndryshimet në nenin 22 i japin DNJF-së të drejtën të ushtrojë ankim ndaj vendimit të gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, kur vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me kriteret ligjore ose kur kërkesa është haptazi e pabazuar apo abuzive.

Gjithashtu, DNJF-së do t'i njihet e drejta të kërkojë sqarimin, plotësimin ose ndreqjen e vendimit gjyqësor në pjesën që lidhet me shpenzimet gjyqësore dhe efektet financiare që mbulohen nga fondet publike. Kjo ndërhyrje synon të ruajë balancën ndërmjet aksesit në drejtësi dhe administrimit të përgjegjshëm të fondeve publike.

10. Efektet e pritshme të projektligjit janë rritja e aksesit real dhe efektiv në drejtësi, zgjerimi i mbrojtjes për kategori të veçanta përfituese, thjeshtimi i procedurave për ndihmën juridike parësore, përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional, rritja e cilësisë së përfaqësimit juridik, garantimi i ndihmës së menjëhershme në raste emergjente dhe mbulimi më i plotë i shpenzimeve që lidhen me realizimin efektiv të së drejtës.

Në të njëjtën kohë, projektligji pritet të rrisë përputhshmërinë e kuadrit ligjor vendas me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së viktimave, garantimit të ndihmës juridike në procedurat penale, luftës kundër terrorizmit dhe mbrojtjes së personave që raportojnë shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian, në përputhje me direktivat që do të transpozohen.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe garanton respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Sa u përket dispozitave me karakter procedural, konkretisht neneve 12, 13 dhe 15 të projektligjit, ato vlerësohet se duhet të miratohen me shumicë të cilësuar, në mbështetje të nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës.

Në përputhje me nenin 26, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, Ministri i Drejtësisë është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektligji, ndaj edhe nisma e propozuar paraqitet si një iniciativë për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të neneve 81, pika 1, 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 100, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji kontribuon në përafrimin e ligjit nr. 111/2017 me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e aksesit në drejtësi, mbrojtjes së viktimave dhe garantimit të ndihmës juridike për kategori të posaçme përfituesish.

Në mënyrë të veçantë, projektligji reflekton standardet e Direktivës (BE) 2012/29 për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, si dhe të Direktivës (BE) (BE) 2016/1919 mbi ndihmën juridike për të dyshuarit dhe të akuzuarit në procedurat penale, për aq sa ndryshimet forcojnë garancitë procedurale dhe efektivitetin e ndihmës juridike.

Gjithashtu, projektligji merr në konsideratë Direktivën (BE) 2017/541 për luftën kundër terrorizmit, përmes përfshirjes së viktimave të terrorizmit ndër kategoritë përfituese, si dhe Direktivën (BE) 2019/1937 për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke

parashikuar ndihmë juridike për personat që raportojnë ose bëjnë publik informacion mbi shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Përmes këtyre ndërhyrjeve, projektligji rrit shkallën e përafrimit me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe forcon mbrojtjen juridike për viktimat, personat vulnerabël dhe subjektet që kanë nevojë për garanci të posaçme për akses efektiv në drejtësi.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban gjithsej **21 nene**.

Neni 1, ndryshon nenin 2 të ligjit, duke zgjeruar qëllimin e tij. Përveç organizimit dhe ofrimit të ndihmës juridike falas, projektligji parashikon se ndihma juridike duhet të kontribuojë edhe në informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi të drejtat, detyrimet dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Neni 2, ndërhyr në nenin 3 të ligjit, duke shtuar përkufizime të reja për “shpenzimet kadastrale dhe noteriale” dhe për “tarifat e tjera të domosdoshme gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit”. Këto përkufizime synojnë të qartësojnë shpenzimet që mund të mbulohen në kuadër të ndihmës juridike, veçanërisht në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Neni 3, ndryshon nenin 5 të ligjit, duke shtuar si formë të ndihmës juridike përjashtimin nga pagimi i tarifave të tjera të domosdoshme gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit, në rastet kur prania e ekspertit është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4, ndryshon nenin 6 të ligjit, duke përfshirë njësitë e vetëqeverisjes vendore ndër institucionet që kontribuojnë në funksionimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Neni 5, ndryshon nenin 7 të ligjit, duke shtuar një kompetencë të re për ministrin e Drejtësisë për miratimin e procedurave që ndiqen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit për pagesat e shpenzimeve të ekspertëve, kur ekspertiza është e detyrueshme sipas legjislacionit procedural.

Neni 6, ndryshon nenin 8 të ligjit, duke qartësuar dhe forcuar detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Ndryshimet ndajnë funksionin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave nga funksioni i informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut. Drejtorisë i shtohet detyra për të informuar subjektet përfituese mbi të drejtën për ndihmë juridike dhe për të kontribuar në edukimin ligjor të publikut përmes materialeve informuese, fushatave ndërgjegjëse dhe aktiviteteve në komunitet.

Neni 7, ndryshon nenin 9 të ligjit, duke forcuar rolin e DNJF-së dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë në përgatitjen dhe organizimin e programeve të trajnimit të vazhdueshëm për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore. Temat dhe aktivitetet trajnuese, sipas fushave të së drejtës dhe kategorive të posaçme përfituese, miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 8, shton nenin 9/1, i cili përcakton detyrat e njësive të vetëqeverisjes vendore në sistemin e ndihmës juridike. Këto njësi kontribuojnë në informimin e publikut, vendosjen në dispozicion të dokumentacionit që lidhet me fushën e tyre të përgjegjësisë dhe bashkërendimin ndërmjet shërbimeve sociale dhe institucioneve përgjegjëse për ndihmën juridike.

Neni 9, ndryshon nenin 11 të ligjit, duke zgjeruar dhe qartësuar kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre. Ndryshimet përfshijnë viktimat e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave, viktimat e terrorizmit, personat që kërkojnë njohjen e statusit të aftësisë së kufizuar, përfituesit e ndihmës ekonomike, pensionit social dhe skemave të tjera të mbrojtjes sociale, personat e komunitetit rom dhe egjiptian për çështje të dokumentacionit dhe regjistrimit civil, si dhe personat që raportojnë ose bëjnë publik informacion mbi shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Neni 10, ndryshon nenin 17 të ligjit, duke thjeshtuar procedurën për përfitimin e ndihmës juridike parësore. Kërkesa i drejtohet ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe kërkuesi paraqet vetëdeklarim të shoqëruar me dokument identifikimi, ndërsa dokumentacioni justifikues kërkohet vetëm kur ka dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e vetëdeklarimit. Gjithashtu, thjeshtohet procesverbali i shërbimit, duke u kufizuar në të dhënat e nevojshme për identifikimin e kërkuarit, problematikën e paraqitur dhe shërbimin e ofruar.

Neni 11, ndryshon nenin 19 të ligjit, duke parashikuar mundësinë e dhënies së ndihmës juridike dytësore edhe për çështje të ndërlidhura ndërmjet të njëjtave palë. Gjithashtu, për disa kategori përfituese, ndihma juridike dytësore synohet të sigurohet, sa të jetë e mundur, nga i njëjti avokat gjatë fazave paraprahe dhe procesit gjyqësor, përfshirë çështjet civile, penale dhe administrative të ndërlidhura.

Neni 12, ndryshon nenin 20 të ligjit, duke parashikuar shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të kërkesave për ndihmë juridike dytësore në rastet e urdhrave të mbrojtjes, urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe çështjeve të tjera urgjente që lidhen me mbrojtjen e viktimave të dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhunës seksuale, trafikimit, të miturve dhe personave me aftësi të kufizuara. Në këto raste, gjyqtari i caktuar vendos menjëherë për caktimin e avokatit dhe urdhëron njoftimin pa vonesë të tij dhe të përfituesit. Kjo dispozitë ka karakter procedural, pasi rregullon mënyrën e shqyrtimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore në raste urgjente, në kuptim të nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës.

Neni 13, shton nenin 21/1, i cili rregullon procedurën e dhënies së ndihmës juridike dytësore për viktimat në procesin penal. Dispozita parashikon shqyrtimin e menjëhershëm të kërkesës nga organi procedues ose gjykata, caktimin e menjëhershëm të avokatit dhe vijueshmërinë, sa të jetë e mundur, të përfaqësimit nga i njëjti avokat në të gjitha fazat e hetimeve paraprahe dhe të procesit gjyqësor. Kjo dispozitë ka karakter procedural, pasi përcakton mënyrën e shqyrtimit të kërkesës dhe caktimit të avokatit për viktimat në procesin penal, në kuptim të nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës.

Neni 14, ndryshon nenin 22 të ligjit, duke qartësuar rastet kur gjykata mund të kërkojë plotësimin e dokumentacionit për shkak të pamundësisë financiare të kërkuarit. Gjithashtu, parashikohet detyrimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe i dhomës vendore të noterisë për të vendosur në dispozicion të gjykatës aktet kadastrale dhe noteriale të nevojshme për shqyrtimin e kërkesës. Neni forcon edhe rolin e DNJF-së, duke i njohur të drejtën për të ankimuar vendimet e pranimit të kërkesës kur ato janë në kundërshtim me kriteret ligjore ose kur kërkesa është haptazi e pabazuar apo abuzive, si dhe të kërkojë sqarimin, plotësimin ose ndreqjen e vendimit në pjesën që lidhet me efektet financiare.

Neni 15, shton nenin 22/1, i cili parashikon procedurën e përshpejtuar për dhënien e ndihmës juridike dytësore në rastet emergjente. Procedura zbatohet për viktimat

e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, viktimat e dhunës seksuale, viktimat e trafikimit, viktimat e terrorizmit, të miturit dhe personat me aftësi të kufizuara, kur kërkohet mbrojtje e menjëhershme ose ndërhyrje urgjente. Dispozita përcakton mënyrën e paraqitjes së formularit, caktimin e menjëhershëm të avokatit, njoftimin e palëve dhe miratimin e formularit dhe formatit standard të vendimit me aktet përkatëse nënligjore. Kjo dispozitë ka karakter procedural, pasi përcakton hapat, afatet dhe mënyrën e dhënies së ndihmës juridike dytësore në rastet emergjente, në kuptim të nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës.

Neni 16, ndryshon nenin 24 të ligjit, duke forcuar kërkesat për specializimin dhe trajnimin e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore. Në këtë dispozitë, parashikohet e drejta e përfituesit për të zgjedhur avokatin nga lista e avokatëve që ofrojnë këtë shërbim. Kur përfituesi nuk e ushtron këtë të drejtë, avokati i zgjedhur nuk pranon, ndodhet në pamundësi ose ekzistojnë shkaqe të tjera që pengojnë përfaqësimin, dhoma vendore e avokatisë cakton avokatin sipas parimit të rotacionit. Neni zgjeron edhe rastet e zëvendësimit të avokatit dhe parashikon vijueshmërinë e përfaqësimit nga i njëjti avokat, kur natyra e çështjes e kërkon.

Neni 17, ndryshon nenin 25 të ligjit, duke zgjeruar përjashtimet nga pagesat dhe shpenzimet për personat që përfitojnë ndihmë juridike dytësore. Përveç shpenzimeve gjyqësore, parashikohen edhe tarifat kadastrale dhe noteriale, shpenzimet përmbartimore dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Neni 18, ndryshon nenin 29 të ligjit, duke parashikuar se personat që përfitojnë ndihmë juridike dytësore kanë të drejtë të mos parapagujnë tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit dhe përjashtohen nga tarifat e tjera të domosdoshme gjatë ekzekutimit të vendimit, kur prania e ekspertit është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19, ndryshon nenin 31 të ligjit, duke rregulluar rastet e kthimit të përfitimeve kur provohet se ndihma juridike ose përjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet është përfituar përmes deklarimeve të rreme, dokumenteve të falsifikuara ose formave të tjera të abuzimit. Në këto raste, DNJF-ja kërkon kthimin e shpenzimeve të kryera dhe, në rast mosekzekutimi vullnetar, paraqet kërkesëpadi në gjykatë. Gjithashtu, afati për paraqitjen e kërkesëpadisë nga përfituesi pas pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore zgjatet nga tre në gjashtë muaj.

Neni 20, përcakton aktet nënligjore që duhet të miratohen për zbatimin e projektligjit.

Neni 21, parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”, ndërsa efektet e tij fillojnë nga data 1 janar 2027.

VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Drejtësisë, pas propozimeve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, e cila është asistuar nga UNDP.

VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organet ligjzbatuese.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektligji nuk pritet të sjellë ndikim shtesë në buxhetin e shtetit përtej fondeve të miratuara për programin e Ndihmës Juridike Falas në ligjin nr. 87/2025 “Për Buxhetin e Vitit 2026” dhe në vendimin nr. 162, datë 19.03.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029”. Kostoja e vlerësuar në rreth 19,000,000 lekë në vit, që rrjedh nga zgjerimi i kategorive përfituese, do të përballohet brenda fondeve të miratuara për programin e Ndihmës Juridike Falas. Gjithashtu, miratimi i akteve nënligjore parashikohet të kontribuojë në përdorimin më efikas të burimeve financiare dhe administrative, nëpërmjet standardizimit të procedurave dhe forcimit të mekanizmave të koordinimit institucional.

MINISTRI

TONI GOGU